




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa e Komunës së Prishtinës,
mbajtur më 31.10.2024.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, Nora Kelmendi (VV), Arbnora Berisha (VV), Mirsad Vitia (VV), Gëzim Sveçla (VV), Jeta Rafuna (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Bahri Gashi (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama - kryetar i kryeqytetit, Alban Zogaj - nënkryetar i kryeqytetit, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Valbona Makolli - drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Jehona Lushaku - nënkryetare dhe drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i komitetit me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik “Plani zhvillimor komunal 2024-2032”;
3. Propozimi-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025;
4. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2024 (TM3);
5. Propozim-vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025;
6. Propozim-vendimi për iniciimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane “B” të lagjes “Prishtina e Re –Zona Lindje”;
7. Propozim –vendimi për iniciimin e Planit të hollësishëm rregullues për pjesën e vazhdimit të rrugës “B” nga rruga “F” deri tek rrethi në rrugën “Isa Kastrati”;
8. Propozim-rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave dhe dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit;
9. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2024-2025 në kryeqytet;
10. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 lidhur me punën e komisionit të aksionarëve, të Ndërmarrjes publike “Termokos”,SHA;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Fehmi Kupina - pyeti të pranishmit në qoftë se keni diçka për të shtuar, para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës.

Arbër Sadiki - tha si propozim largimin e pikave, pikës gjashtë: Propozim-vendimi për iniciimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e re – Zona lindje", dhe pikës shtatë: Propozim –vendimi për iniciimin e Planit të hollësishëm rregullues për pjesën e vazhdimit të rrugës "B" nga rruga "F" deri tek rrethi në rrugën "Isa Kastrati", nga ky rend i ditës për arsye të disa rregullimeve teknike.

Nora Kelmendi - tha se dëshiroj ta di nga drejtori se cila është arsyeja e tërheqjes së këtyre dy pikave nga rendi i ditës. Ajo po ashtu tha se vitin e kaluar e kemi pas në Kuvend zonën e perëndimit ndërsa tash zonën e lindjes, cila është arsyeja që nuk i keni sjellë të dyja së bashku?

Arbër Sadiki - tha se njëra është për shkaqe teknike, ndërsa tjetra për arsye se shohim që ka ende hapësira për shpronësimin e rrugës B. Kurse për pyetjen tjetër ai tha se për shkak të vëllimit të madh të punës në këto plane mënyra më e mirë është që t'i trajtojmë ndaras dhe jo së bashku.

Nora Kelmendi - tha se sipas ligjit çdo tri vite duhet ta sjellni për shqyrtim në asamble një raport monitorues për këto plane, a e keni sjellë ju ndonjë të tillë?

Gëzim Sveçla - tha se në mbledhjet e kaluara në mbledhjet e KPF-së, por edhe siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, kryetari duhet të raportojë dy herë gjatë vitit në Kuvend, ndërsa tash jemi në muajin tetor dhe pse nuk ka ndodhur asnjëherë gjatë këtij viti.

Kryetari - tha se raportimin e kemi pasur si pikë në rend të ditës para disa seancave, por për shkaqe të ndërprejes nuk kemi arritur të raportojmë, por mundemi për mbledhjet e ardhshme ta sjellim në rendin e ditës.

Gëzim Sveçla - tha se a janë evituar vërejtjet nga Ministria e Planifikimit Hapësinor në draftin të cilin e keni dërguar më heret në lidhje me Propozimvendimin për vënien në diskutim planit zhvillimor komunal 2024-2032?

Arbër Sadiki - tha se ne kemi mbajtur diskutimin publik ku edhe kemi pas mundësinë që përmes rekomandimeve që kemi pranuar t'i bëjmë disa ndryshime, por edhe herën e kaluar ju kam treguar se nuk jemi të obliguar që t'i marrim parasysh ato vërejte të cilat kanë ardhur pas afatit kohor.

Gëzim Sveçla - tha se pasi që kemi pranuar opinion për kundërshtime nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës propozoj që pika e dytë "**Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik "Plani zhvillimor komunal 2024-2032"**", të largohet nga rendi i ditës. Sveçla po ashtu për pikën e tretë të rendit të ditës "**Propozimi-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025**", pasi që nuk ka asnjë ndryshim nga hera e fundit pavarësisht nga vërejtjet e dhëna herën e fundit propozoj ta largojmë nga rendi i ditës.

Kryetari - deklaroi rreth **Propozim-vendimit për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025**, që kemi bërë disa ndryshime duke u bazuar në ato të cilat i kemi diskutuar.

Leutrim Retkoceri - tha se dua ta pyes kryetarin në lidhje me pikën e tretë të rendit të ditës, pse nuk është bërë prezentimi i daft-buxhetit në dëgjim publik para qytetarëve dhe po ashtu nga hera

e kaluar kemi kërkuar një projekt për të na informuar më konkretisht se çfarë përmban buxheti i vitit 2025.

Kryetari - deklaroi se ne i kemi mbajtur dëgjimet publike buxhetore dhe i kemi përfunduar të gjitha proceset që kërkohen me ligj, prandaj nuk shoh ndonjë arsye që mos ta sjellim në Kuvend për shqyrtim.

Jeta Rafuna - tha se dua ta pyes drejtoreshën e financave lidhur me pikën e pestë të rendit të ditës **“Propozim-vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025”**, sipas informatave niveli qëndror e ka pezulluar këtë Vendim deri në vitin 2026, prandaj nëse e shihni të arsyeshme ta largojmë këtë pikë nga rendi i ditës.

Valbona Makolli - drejtoreshë në Drejtorinë e Financave, tha për pikën e tretë **“Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025”**, nuk shoh ndonjë arsye që ta largojmë nga ky rend i ditës. Ajo lidhur me dëgjimet buxhetore për draft-buxhetin tha se asnjëherë nuk janë publikuar para se me ardh si pika të rendit të ditës në Kuvend, por vetëm janë shpërndarë përmes asamblesë. Drejtoresha tha se ne kemi mbajtur tri dëgjime buxhetore në të cilat kemi pranuar kërkesa të ndryshme të qytetarëve të cilat janë shqyrtuar dhe disa prej tyre të inkorporuara në këtë draft-buxhet. Ndërsa për pikën e pestë **“Propozim-vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025”** tha se nuk kam ndonjë njoftim për pezullim, prandaj për çdo rast ju lajmëroj në ditën e mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit.

Jehona Lushaku - tha se kam një kërkesë lidhur me një pikë të re, pas rregullimit të dy anekseve të kopshteve kemi një kërkesë për disa edukatore shtesë. Lushaku tha se për shkak të numrit të limituar ne kemi bërë edhe një kërkesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që një numër i lirë për edukatore që ekziston në shkolla të mesme të kalojë në shkolla fillore dhe parafilor, por ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje. Ajo tha se ne kemi marrë dakordimin nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Financave që nëse kalon përmes asamblesë është gjithçka në rregull nuk ka ndonjë pengesë.

Kryesues - tha se deri tash kemi kërkesën nga z.Arbër Sadiki, drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, për largimin e pikës gjashtë dhe shtatë, ndërsa nga z.Sveçla kemi kërkesë për largimin e pikës dy dhe tre nga rendi i ditës. Ai shtoi se para disa mbledhjeve kam marr një opinion ligjor nga zyra ligjore dhe rekomandohet se Komiteti për Politikë dhe Financa nuk ka kompetencë për largimin apo shtimin e pikave nga rendi i ditës. Kryesuesi tha se unë nuk jam as për dhe as kundër largimit të këtyre pikave nga rendi i ditës, prandaj kërkoi nga ju që t'i drejtoheni me një kërkesë Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe në të ardhmen ta kemi më të qartë që mos të veprojmë me dy standarde.

Gëzim Sveçla - tha se ne si Komitet për Politikë dhe Financa duhet të veprojmë ashtu si kemi vepruar në të kaluarën nëse ka propozime me votë mund të vendosim qoftë për t'i larguar apo për t'i inkuadruar ato në rend të ditës.

Leutrim Retkoceri - tha po ashtu se derisa nuk ta kemi një përgjigje të qartë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, apo nga organet përkatëse që bëjnë monitorimin e punës së kryetarit dhe kuvendeve, ne duhet të veprojmë në atë formë siç kemi vepruar deri sot.

Bahri Gashi - tha se ajo çfarë po diskutojmë këtu është mjaft e lehtë që ta zgjidhim, ne kemi pranuar opinionin nga zyra ligjore dhe në qoftë se ajo nuk i pëlqen dikujt, atëherë janë instancat tjera të cilat kemi të drejtën t'i shfaqim pakënaqësitë tona. Ai tha se nëse nuk jeni të pajtimit për

ta pranuar opinionin ligjor, atëherë cila ka qenë edhe arsyeja pse e kemi kërkuar një gjë të tillë nga zyra ligjore?

Gëzim Sveçla - tha se pasi kemi marr vetëm opinion ligjor, është e drejta jonë prapë të vendosim se çfarë të vendosim me këto propozime. Ai tha se derisa kemi hapësira ligjore të cilat nuk parashihen në bazë të dispozitave ligjore, atëherë veprohet me praktikat në të cilat kemi vepruar deri më sot.

Milazim Vitija - tha se në të kaluarën deri më sot kemi vepruar në formën që kemi larguar pika nga rendi i ditës nëse nuk ka qenë askush nga drejtoria përkatëse për të sqaruar informata më të detajuara rreth atyre projekteve. Ai tha se tash e kemi edhe opinionin ligjor që nuk rekomandohet të largohen apo futen pika të reja në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa. Po ashtu e kemi kryetarin, nënkryetarët dhe drejtorat prezent për të na dhënë sqarime më shumë dhe nuk e shoh të arsyeshme largimin e këtyre pikave nga rendi i ditës.

Kryesuesi - tha se pasi kemi vetëm opinion ligjor dhe nuk jemi të dakordimit për këtë derisa ta pranojmë një interpretim ligjor nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal se si të veprohet, do të vazhdojmë me metodën e vjetër pra me të drejtën e votës të vendosim për largimin apo aprovimin e pikave për rend të ditës.

Bahri Gashi - tha se sa i përket Planit Zhvillimor Komunal, ka një rëndësi të veçantë për të gjithë qytetarët e Kryqytetit dhe mendoj se duhet që ta votojmë që ta kemi në diskutim publik.

Gëzim Sveçla - tha se kemi një informatë zyrtare nga Asociacioni i Komuna të Kosovës rreth pikës “**Propozim-vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025**”, prandaj mund të tërhiqet si pikë edhe para mbajtjes së seancës.

Leutrim Retkoceri - tha se propozoj po ashtu largimin e pikës së tetë “**Propozim-rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave dhe dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak së një vit**”, pasi që herën e kaluar edhe pse ka kaluar në Kuvend nuk është bërë publik asnjëherë vendimi. Ai tha se prapë po na vjen e njëjta rregullore duke mos i përfshirë vërejtjet që janë dhënë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Bahri Gashi - tha se nuk do të duhej të paraqitej si problem për neve se kush do të vjen për të na dhënë sqarime rreth pikave që i kemi në rend të ditës, besoj se rëndësi ka vetëm të jetë pjesë e ekzekutivit.

Nora Kelmendi - tha se nuk pajtohna me këtë, pasi që nuk është në rregull që drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të jap sqarime për pikën e cila ka të bëjë me Drejtorinë e Pronës. Ai shtoi se pavarësisht kësaj në rast se nuk bëhen ato ndryshime të cilat i kemi dhënë si rekomandime grupi jonë, apo ato vërejtje që kanë ardhur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ne si grup nuk do t'i mbështesim.

Bekim Brestovci - tha se “**Propozim-rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave dhe dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak së një vit**”, përveç që ka të bëjë me Drejtorinë e Pronës, ajo ka përfshirje të kompetencave edhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Ai tha se kërkesat me rekomandime të cilat kanë ardhur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kanë të bëjnë kryesisht me nënparagrafin 1.5, të nenit 6 të kësaj rregulloreje, ku është e përcaktuar dhënia në shfrytëzim e lokaleve, banesave në pronësi të komunës. Dhe sipas kësaj kërkesë dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për dhënien e pronës

në këtë rast lokaleve ai tha se e kemi bërë ndryshimin dhe i kemi larguar në këtë draft rregullore. Brestovci shtoi se kemi ndryshuar paragrafin 5, të nenit 13, ku thuhet se çmimet e kompensimit të shfrytëzimit të dhënies së pronave në shfrytëzim janë caktuar në bazë të Rregullores për taksa dhe tarifa të Komunës së Prishtinës, ashtu siç është kërkuar nga MAPL. Drejtori tha se po ashtu me rekomandim të MAPL-së e kemi larguar nenin 18, të kësaj draft-rregulloreje ku thuhej se me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Leutrim Retkoceri - tha që sipas rekomandimit nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal thuhet se rregullorja e tanishme duhet të shfuqizohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve dhe pastaj të sjellet për dëgjim publik në Kuvend draft-rregullorja e re. Ai tutje pyeti se në çfarë forme janë duke u dhënë pronat komunale në shfrytëzim kur nuk kemi rregullore në fuqi.

Pika e dytë “Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik “Plani zhvillimor komunal 2024-2032”, me 6 vota kundër, 3 për dhe 1 abstenim, largohet nga rendi i ditës me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Arbër Sadiki.

Pika e tretë “Propozimi-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2025”, me 6 vota kundër, 3 për dhe 1 abstenim, largohet nga rendi i ditës me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Arbër Sadiki.

Pika e pestë “Propozim-vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025”, me 10 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, largohet nga rendi i ditës me propozim të Jeta Rafunës.

Pika e tetë “Propozim-rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave dhe dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak së një vit”, me 6 vota për, 2 vota kundër dhe 1 abstenim, largohet nga rendi i ditës me propozim të Leutrim Retkocerit.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2024 (TM3);**
- 3. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2024-2025 në kryeqytet;**
- 4. Raport vjetor i punës për vitin 2023 lidhur me punën e komisionit të aksionarëve, të Ndërmarrjes publike “Termokos“, SHA;**
- 5. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa, pas vërejtjeve të dhëna nga Leutrim Retkoceri, mbetet të plotësohet nga zyra e shërbimit të Kuvendit dhe të sjellet për miratim në mbledhjen e ardhshme.

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2024(TM3);

Valbona Makolli - tha se raportin e kemi sjell më kohë dhe të dhënat janë të paraqitura sipas raportit nga Ministria e Financave për periudhën raportuese. Ajo tha se në këtë raport janë shpenzuar 32 (tridhjetë e dy) milionë e 392 (treqind e nëntëdhjetë e dy) mijë e 54 (pesëdhjetë e katër) euro, prej të cilave në 5 kategori kryesore ku janë: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, komunalitë, subvencionet dhe shpenzimet kapitale. Drejtoresha tha se për shkak të shpenzimeve përmbartimore të kontratave kolektive, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, besoj se për muajt e ardhshëm nëntor dhe dhjetor mund të kemi probleme financiare dhe duhet të bëjmë ndonjë transfer nga kategoritë e tjera. Ajo tha po ashtu se në kategorinë e mallrave dhe shpenzimet kemi shpenzuar 8 milionë 69 mijë 308 apo 27.01 % të mallrave në total, shpenzime për komunalitet janë 420 mijë 247 apo 14 % që shpresoj që kjo kategori në tremujorin e fundit të shpenzohet, por fal kohës së mirë nuk kemi pas nevojë për shpenzime ekstra sikurse viteve tjera. Ndërsa te kategoria e subvencioneve 2 milionë e 319 mijë 531, apo 40.6 % për këtë periudhë raportuese, te shpenzimet kapitale janë 11.515.986, 92 apo 12.91 %. Drejtoresha theksoi se në krahasim me vitin e kaluar shpenzimet kanë rritje të lehtë me 13.99 %, kurse sa i përket realizimit të planifikuar nga të hyrat vetanake për periudhën për të cilën po raportojmë vlerat janë 8 milionë 299 mijë e 624 apo 21.22 nga planifikimi i përgjithshëm. Në fund ajo tha se të gjitha detajet tjera janë të paraqitura në formë tabelare për secilën drejtori për shpenzimet dhe të hyrat sa i ka komuna.

Gëzim Sveçla - pyeti drejtoreshën se kur është caktuar përqindja e investimeve kapitale, a i keni larguar mjetet që janë marrë nga përmbartuesi, sepse nëse nuk janë larguar d.m.th kjo shifër e investimeve kapitale nuk është e saktë? Po ashtu Sveçla pyeti drejtoreshën si qëndrojmë me të hyrat në këtë tremujor dhe pse ka ngecje në të hyra.

Valbona Makolli - tha se kam kërkuar në Asociacionin e Komunave që këtë të drejtë ta paraqesim poshtë, por nëse kërkohet një gjë e tillë mund ta bëjmë një tabelë dhe të jap sqarime. Ndërsa për tremujorin tha se në krahasim me periudhën e kaluar jemi më mirë, por ngecja ka ardhur te ndikimi, ka ardhur te falja e tatimit te disa qytetarë dhe për shkak të parapagimit. Ajo shtoi se për të gjitha hollësitë tjera dhe shifra më të sakta do t'ju njoftoj edhe në mbledhje të Kuvendit.

Pika e tretë

Informatë për fillim të vitit shkollor 2024/2025 në Kryeqytet.

Jehona Lushaku-Sadriu - tha se kësaj informate një kapitull të veçantë ia kemi kushtuar mësimin tërëditor, kështu që e kemi përshkruar në detaje modelin se si e kemi zbatuar mësimin tërëditor, menaxhimin e mësimin tërëditor për klasat prej 1-5 e që ka pasur ndikime buxhetore. Ne e kemi planifikuar edhe zgjatjen e orarit, si dhe disa aktivitete shtesë. Sa i përket ushqimit tha se ushqimi sigurohet nga "Kuzhina Qendrore". Tani momentalisht i kemi 5 shkolla me mësim tërëditor, gjithsej 3100 nxënës të cilët ushqehen çdo ditë, ushqehen edhe stafi i shkollës duke i përfshirë edhe puntorët teknikë dhe punëtorët për menaxhmentin e shkollave. Po ashtu e kemi miratuar një plan të trajnimeve të cilat do të bëhen trajnime për stafin kryesisht për stafin e ri të cilët kanë hy tash në sistem. Kemi marrë edhe staf shtesë, sepse kemi pasur një konkurs të cilin e kemi menaxhuar suksesshëm, ka pas aplikime të shumta dhe janë shqyrtuar të gjitha ankesat dhe nuk ka pas parregullsi evidente që mundën me u raportua.

Gëzim Sveçla - tha se sa i përket çështjes së aspektit financiar në planifikimin e buxhetit në draftin që na është dorëzuar neve vërejmë se janë shtuar edhe dy milionë euro, por kërkoi të dijë se a janë paraparë për mësimin tërëditor apo edhe për shujta dhe se a mendohet që përveç në pesë shkolla që është filluar mësimi tërëditor a do të zgjerohet edhe nëpër shkollat tjera.

Jehona Lushaku- tha se në buxhetin për Drejtorinë e Arsimit janë shtuar edhe një milion e shtatëqind mijë euro kryesisht për mësimin tërëditor. Sa i përket mësimin tërëditor tha se në fillim kemi hasur në disa pengesa me listat e peticioneve që partia Vetëvendosje dhe PDK-ja i kanë organizu nëpër shkolla të nënshkruara, ku ka pasur prindër të cilët e kanë kundërshtuar dhe këta prindër janë edhe anëtarë të Vetëvendosjes.

Gëzim Sveçla - tha se sa i përket deklaratës së nënkryetares, ajo ka me marrë përgjegjësi politike edhe ligjore për këto deklarata, që ka thënë se: “Prej Vetëvendosjes janë të organizuara”.

Jehona Lushaku - tha se këto kanë qenë të organizuara prej njerzëve të cilët janë anëtarë të juaj në secilën prej shkollave.

Leutrim Retkoceri - tha se sa i përket akuzave që nënkryetarja i drejtoi ndaj PDK-së konsideroj se ato nuk qëndrojnë, kështu që edhe ligji ia lejon që pas orës 16:00, me u marrë me partitë politike, kështu që ata domosdo nuk e përfaqësojnë asnjë parti, nuk janë të autorizuar me përfaqësu askënd, as partitë politike. Po ashtu prindërit që janë mësimdhënës ose asamblistë kanë të drejtë me shpreh mendimin e tyre dhe pse kjo tendencë me ia ndal lirinë. Keni blerë kuzhina me kontratë njëburimore të jashtëligjshme me ndërmarrje publike dhe mendoj se aty është edhe një vepër penale. Arsyetimin dhe qëndrimin që po e paraqitni mendoj se e keni gabim, se po dëshiron me akuzë me ndërtu diçka, por s’mund të ndërtosh, përkundër kësaj vetëm se e zvogëlon projektin.

Pika e katërt

Raporti vjetor i punës për vitin 2023 për punën e aksionarëve të Ndërmarrjes publike “Termokos”

Milazim Vitija, - në cilësinë e anëtarit të komisionit komunal në NPL “Termokos” tha se për Raportin vjetor të punës për vitin 2023 të kësaj ndërmarrjeje do të raportojmë në seancën e Kuvendit.

Kryesuesi - tha se kjo pikë mbetet që të raportohet në seancën e Kuvendit.

Mbledhja mbaroi në orën 12:15.

Procesmbajtësi
Arton Brahim

